

Nr. 2505/039 K (e-k) Prot.
Tiranë, më datë 03/05/2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Z. Ilirjan CELIBASHI

Lënda: **DENONCIM Nr. 25** – Lidhur me
postimet me karakter partiak dhe
elektoral në faqet zyrtare të Kryetarëve
të shtatë Bashkive, për qëllime elektorale
në përfitim të Subjekteve Zgjedhore
“Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe
“Koalicioni Partia Demokratike –
Aleanca për Shqipërinë Madhështore”.

I nderuar z. Komisioner!

Të nderuar Drejtues të Administratës së KQZ-së!

KRIIK ka theksuar vazhdimisht se faqet zyrtare në rrjetet sociale të Institucioneve Publike dhe Drejtuesve të tyre duhet të trajtohen me të njëjtën rëndësi dhe t’u nënshtrohen të njëjtave rregulla si dhe faqet zyrtare të internetit të këtyre institucioneve.

Këto faqe janë tashmë pjesë e pandashme e komunikimit institucional dhe nuk mund të konsiderohen si hapësira private apo të pambikëqyrura, për shkak të ndikimit që kanë në formësimin e perceptimit publik dhe transparencën e veprimtarisë institucionale.

Për më tepër, duke qenë se rrjetet sociale kanë një audiencë shumë më të gjerë e më të larmishme se kanalet tradicionale, dhe si të tilla përdoren gjerësisht nga qytetarët si burim informacioni dhe ndërveprimi me institucionet, **përdorimi i tyre nga funksionarët publikë duhet të jetë i përmbytur dhe rreptësisht institucional.**

Komunikimi përmes këtyre platformave nuk mund të jetë një përzierje e mesazheve politike partiake dhe atyre institucionale, pasi kjo përbën një konfuzion të qëllimshëm mes funksioneve e autoritetit të shtetit dhe qëllimeve partiake të subjektit politik që përfaqëson zyrtari.

Edhe pse kuadri ligjor nuk e përcakton në mënyrë eksplicite statusin e rrjeteve sociale si kanale zyrtare komunikimi, **parimi i ndarjes së partisë nga shteti**, i sanksionuar në standardet ndërkombëtare që Shqipëria ka pranuar, **e bën të papranueshme përdorimin e platformave me përmbajtje institucionale** për propagandë politike.

Ky është një veprim që **cënon barazinë e subjekteve zgjedhore dhe deformon informacionin publik**, duke i dhënë avantazh të padrejtë aktorëve në pushtet.

Në këtë kontekst, **KRIIK vlerëson pozitivisht miratimin e aktit nënligjor nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, konkretisht Vendimi nr. 240, datë 04.03.2025**, “Për rregullat e përdorimit dhe komunikimit në rrjetet sociale dhe median online nga institucionet publike dhe funksionarët publikë në zgjedhje”.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Në gjykimin e KRIIK, **ky vendim përfaqëson një hap të rëndësishëm** drejt normimit të përdorimit të rrjeteve sociale nga funksionarët publikë dhe subjektet zgjedhore, dhe **kufizon**, për aq sa është e mundur brenda kuadrit ligjor ekzistues, **përdorimin e burimeve publike për avantazh elektoral**.

Ndër të tjera, vendimi përcakton, deri në njëfarë mase, llogarinë në rrjetet sociale të funksionarit publik, dhe **vendos detyrime në lidhje me çfarë mund dhe nuk mund të postohet në këto llogari**, duke ndaluar postimet me përmbajtje politike apo partiake në to.

Ky vendim është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ndihmon në ruajtjen e **ndarjes së funksioneve publike nga aktivitetet elektorale**, duke përforcuar neutralitetin institucional gjatë proceseve zgjedhore.

Konkretisht pika 1 e Vendimit nr. 240, datë 04.03.2025, përcakton se: “1. Llogari zyrtare në rrjetet sociale është llogaria që është hapur dhe **përdoret nga funksionari publik për shkak të detyrës që kryen, e cila përmban emrin e institucionit dhe funksionin publik**, si dhe llogaria që është hapur dhe përdoret nga institucioni publik përkatës, përdorimi dhe përditësimi i së cilës bëhet nga strukturat përkatëse për median dhe informimin në këtë institucion. Nuk përfshihen në këtë përkufizim llogaritë personale dhe adresat në rrjetet sociale, të cilat përmbajnë vetëm emrin dhe mbiemrin e funksionarit publik **dhe nuk lidhen me funksionin publik të tij**”. (i plotë vendimi gjendet në Lidhjen nr. 2, për shkak të mungesës së link-ut në faqen e internetit të KQZ-së).

Ndërkohë në nenin 2 parashikohet se: “*Funksionarët publikë të çdo niveli **nuk mund të përdorin direkt ose indirekt llogaritë e tyre zyrtare në rrjetet sociale për qëllime partiake apo elektorale**. Pasqyrimi i veprimtarive partiake dhe elektorale lejohet vetëm në llogaritë personale në këto rrjete*”.

Ndërsa në nenin 4 të tij përcaktohet se: “*Ndalohej pasqyrimi i veprimtarive politike dhe elektorale, si dhe postimi i mesazheve elektorale në faqet zyrtare të internetit, në rrjetet sociale të institucionit publik dhe në ato zyrtare të vetë funksionarit publik*”.

KRIIK është duke monitoruar llogaritë në media sociale të Kryetarëve të Bashkive në vend.

Konstatohet se pesë prej Kryetarëve kanë në përdorim llogari zyrtare në rrjetet sociale, të cilat janë në shkelje të Vendimit të KSHZ nr. 240 pasi **përmbajnë emrin e institucionit dhe funksionin publik**, ndërkohë që postojnë si aktivitetin e tyre institucional, ashtu edhe atë partiak e elektoral, i cili lidhet drejtpërdrejt dhe është në përfitim të Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Konkretisht:

1. Faqja zyrtare e Kryetarit të Bashkisë Fier z Armando Subashi

Në këtë faqe e cila është publike është cituar **funksioni i z. Subashi**: “Kjo është Faqja Zyrtare e Kryetarit të Bashkisë Fier, Armando Subashi” dhe **i institucionit** “bashkiafier.gov.al”.

Karakterit i postimeve në këtë faqe është i përzier me aktivitete të karakterit institucional të funksionit publik si Kryetar Bashkie, si dhe me aktivitete të shumta të karakterit politik e elektoral të Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Address:
Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:
P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Referuar Seksionit “Transparenca” të kësaj faqeje, ajo mirëmbahet nga *dhe* “ka 7 administratorë”.

Nuk ka informacion nëse këta persona janë nga stafi i Bashkisë apo janë njerëz të punësuar privatisht nga z. Subashi. (*shih pikën 1.1. në Lidhjen nr. 1*).

Gjithashtu, theksohet se **edhe faqja zyrtare në Instagram ka të njëjtën përmbajtje e problematikë.**

2. Faqja zyrtare e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë z. Kreshnik Hajdari

Në këtë faqe e cila është publike është cituar **funksioni i z. Hajdari**: “Faqja Zyrtare e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë”.

Karakteri i postimeve në këtë faqe është i përzier me aktivitete të karakterit institucional të funksionit publik si Kryetar Bashkie, si dhe me **aktivitete të shumta të karakterit politik e elektorale** të Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”. (*shih pikën 1.2. në Lidhjen nr. 1*).

Gjithashtu, theksohet se **edhe faqja zyrtare në Instagram ka të njëjtën përmbajtje e problematikë.**

3. Faqja zyrtare e Kryetarit të Bashkisë Vlorë z. Ermal Dredha

Në këtë faqe e cila është publike është cituar **funksioni i z. Dredha**: “Kryetar i Bashkisë Vlorë”.

Karakteri i postimeve në këtë faqe është i përzier me aktivitete të karakterit institucional të funksionit publik si Kryetar Bashkie, si dhe me **aktivitete të shumta të karakterit politik e elektorale** të Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Referuar Seksionit “Transparenca” të kësaj faqeje, ajo mirëmbahet nga *dhe* “ka 6 administratorë”.

Nuk ka informacion nëse këta persona janë nga stafi i Bashkisë apo janë njerëz të punësuar privatisht nga z. Dredha. (*shih pikën 1.3. në Lidhjen nr. 1*).

Gjithashtu, theksohet se **edhe faqet zyrtare në Instagram dhe në TikTok kanë të njëjtën përmbajtje e problematikë.**

4. Faqja zyrtare e Kryetarit të Bashkisë Himarë z. Vangjel Tavo

Në këtë faqe e cila është publike është cituar **funksioni i z. Tavo**: “Vangjel Tavo është Kryetar i Bashkisë Himarë. Ai ka shërbyer në disa legjislatura si Deputet, Ministër i Shëndetësisë dhe Zv/Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë”.

Karakteri i postimeve në këtë faqe është i përzier me aktivitete të karakterit institucional të funksionit publik si Kryetar Bashkie, si dhe me **aktivitete të shumta të karakterit politik e elektorale** të Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Referuar Seksionit “Transparenca” të kësaj faqeje, ajo mirëmbahet nga *dhe* “ka 5 administratorë”.

Nuk ka informacion nëse këta persona janë nga stafi i Bashkisë apo janë njerëz të punësuar privatisht nga z. Tavo. (shih pikën 1.4. në Lidhjen nr. 1).

Gjithashtu, theksohet se **edhe faqja zyrtare në Instagram ka të njëjtën përmbajtje e problematikë.**

5. Faqja zyrtare e Kryetarit të Bashkisë Selenicë z. Nertil Bellaj

Në këtë faqe e cila është publike është cituar **funksioni i z. Bellaj**: “Kryetar i bashkisë Selenicë”.

Karakteri i postimeve në këtë faqe është i përzier me aktivitete të karakterit institucional të funksionit publik si Kryetar Bashkie, si dhe me aktivitete të shumta të karakterit politik e elektorale të Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”. (shih pikën 1.5. në Lidhjen nr. 1).

Gjithashtu, theksohet se **edhe faqet zyrtare në Instagram dhe në kanalin Youtube kanë të njëjtën përmbajtje e problematikë.**

6. Faqja zyrtare e Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe z. Tonin Marinaj

Në këtë faqe e cila është publike është cituar **funksioni i z. Marinaj**: “Faqja zyrtare e kryetarit të bashkisë Malësi e Madhe” dhe e **institucionit** “bashkiamalesiemadhe.gov.al”.

Karakteri i postimeve në këtë faqe është i përzier me aktivitete të karakterit institucional të funksionit publik si Kryetar Bashkie, si dhe me aktivitete të shumta të karakterit politik e elektorale të Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Referuar Seksionit “Transparenca” të kësaj faqeje, ajo mirëmbahet nga *dhe* “ka 4 administratorë”.

Nuk ka informacion nëse këta persona janë nga stafi i Bashkisë apo janë njerëz të punësuar privatisht nga z. Marinaj. (shih pikën 1.6. në Lidhjen nr. 1).

Gjithashtu, theksohet se **edhe faqet zyrtare në Instagram dhe në TikTok kanë të njëjtën përmbajtje e problematikë.**

7. Faqja zyrtare e Kryetarit të Bashkisë Kavajë z. Fisnik Qosja

Në këtë faqe e cila është publike është cituar **funksioni i z. Qosja**: “Kryetar i Bashkisë Kavajë”.

Karakteri i postimeve në këtë faqe është i përzier me aktivitete të karakterit institucional të funksionit publik si Kryetar Bashkie, si dhe me aktivitete të shumta të karakterit politik e elektorale Subjekti Zgjedhor “Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore”. (shih pikën 1.7. në Lidhjen nr. 1).

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Gjithashtu, theksohet se **edhe faqja zyrtare në Instagram ka të njëjtën përmbajtje e problematikë.**

Në gjykimin e KRIIK, këto Faqe në rrjetet sociale **janë Faqe Zyrtare të Funkionarëve Publikë, në të cilat është bërë pasqyrimi i veprimtarive politike dhe elektorale, si dhe postimi i mesazheve elektorale**, krahas pasqyrimin të aktiviteteve institucionale, duke iu dhënë këtyre të fundit meritë partiake e elektorale, në favor dhe përfitim të drejtëpërdrejtë të Subjekteve Zgjedhore “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe “Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore”.

Kjo veprimtari **përbën shpërdorim të funksionit publik, të autoritetit shtetëror, si dhe përdorim të aseteve institucionale, burimeve njerëzore e financiare të tij**, ndërkohë që shënjon edhe **cënimin ndjeshëm të barazisë së garës elektorale.**

KRIIK shpreh shqetësimin se përpos përfitimeve të drejtëpërdrejta elektorale, **kjo sjellje është një model tejet negativ dhe një sfidë ndaj ligjit**, ndërkohë që Vendimi nr. 240 ka gati dy muaj që është miratuar përfshirë dakordësinë e dy partive më të mëdha, Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike.

Lidhur me gjithë sa më sipër, **KRIIK nxit KQZ-në t’i marrë në shqyrtim këto Denoncime** e procedojë sipas parashikimeve ligjore **për të sanksionuar Kryetarët e Bashkive të sipërpërmendur** bazuar në parashikimet e nenit 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor, si dhe Subjektin Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” (si shkelës të përsëritur) dhe Subjektin Zgjedhor “Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore”, si përfitues të drejtëpërdrejtë të këtyre shkeljeve, bazuar në nenin 172 të Kodit Zgjedhor.

Në përfundim, **KRIIK nxit KQZ-në që t’i bëjë thirrje urgjente të gjithë funksionarëve publikë që të riorgannizojnë e sjellin konform ligjit llogaritë e tyre zyrtare dhe ato personale** në rrjetet sociale për ditët e mbetura të fushatës, por edhe më tej.

Publikimi i aktiviteteve dhe mesazheve politike e elektorale duhet **të bëhet vetëm në llogaritë personale të funksionarit publik**, ashtu sikurse aktivitetet dhe mesazhet institucionale duhet **të publikohen vetëm në llogaritë zyrtare të funksionarëve publikë** dhe të institucionit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

Me konsideratë,

**Për Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto Gogo
Kryetar**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana


Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

LIDHJA NR. 1: Postime me përmbajtje partiake në faqet zyrtare të Kryetarëve të Bashkive.

1.1. Faqet Zyrtare në rrjetet sociale të Kryetarit të Bashkisë Fier z. Armando Subashi dhe disa nga postimet e shumta me karakter partiak e elektoral.

1.1.1. Faqja zyrtare në Facebook:





Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



Address:


Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



1.6.2. Faqja Zyrtare në Instagram:



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

1.2. Faqet Zyrtare në rrjetet sociale të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë z. Kreshnik Hajdari dhe disa nga postimet e shumta me karakter partiak e elektoral.

1.2.1. Faqja zyrtare në Facebook:






Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania




Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



1.2.2. Faqja Zyrtare në Instagram:



Address:



Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

1.3. Faqet Zyrtare në rrjetet sociale të Kryetarit të Bashkisë Vlorë z. Ermal Dredha dhe disa nga postimet e shumta me karakter partiak e elektoral.

1.3.1. Faqja zyrtare në Facebook:






Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



Address:


Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:


P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



1.3.2. Faqja Zyrtare në Instagram:



1.3.3. Faqja Zyrtare në TikTok:



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

1.4. Faqet Zyrtare në rrjetet sociale të Kryetarit të Bashkisë Himarë z. Vangjel Tavo dhe disa nga postimet e shumta me karakter partiak e elektoral.

1.4.1. Faqja zyrtare në Facebook:






Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania




Address:


Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



1.4.2. Faqja Zyrtare në Instagram:



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

1.5. Faqet Zyrtare në rrjetet sociale të Kryetarit të Bashkisë Selenicë z. Nertil Bellaj dhe disa nga postimet e shumta me karakter partiak e elektoral.

1.5.1. Faqja zyrtare në Facebook:






Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania




Address:


Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



1.5.2. Faqja Zyrtare në Instagram:



1.5.3. Faqja Zyrtare në kanalin Youtube:



Address:




Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

1.6. Faqet Zyrtare në rrjetet sociale të Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe z. Tonin Marinaj dhe disa nga postimet e shumta me karakter partiak e elektoral.

1.6.1. [Faqja zyrtare në Facebook:](#)






Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania




Address:


Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:


P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



1.6.2. Faqja Zyrtare në Instagram:



1.6.3. Faqja Zyrtare në TikTok:



Address:


Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

1.7. Faqet Zyrtare në rrjetet sociale të Kryetarit të Bashkisë Kavajë z. Fisnik Qosja dhe disa nga postimet e shumta me karakter partiak e elektoral.

1.7.1. [Faqja zyrtare në Facebook:](#)






Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania





Address:


Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



1.7.2. Faqja Zyrtare në Instagram:



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

LIDHJA NR. 2.

Vendimi nr. 240, datë 04.03.2025 i Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve “Për rregullat e përdorimit dhe komunikimit në rrjetet sociale dhe median online nga institucionet publike dhe funksionarët publikë në zgjedhje”.

Data: 4.3.2025

Nr: 240

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

RREGULLAT E PËRDORIMIT DHE KOMUNIKIMIT NË RRJETET SOCIALE DHE MEDIAN ONLINE NGA INSTITUCIONET PUBLIKE DHE FUNKSIONARËT PUBLIKË NË ZGJEDHJE

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh” e “n”, dhe pika 2, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

V E N D O S :

1. Llogari zyrtare në rrjetet sociale është llogaria që është hapur dhe përdoret nga funksionari publik për shkak të detyrës që kryen, e cila përmban emrin e institucionit dhe funksionin publik, si dhe llogaria që është hapur dhe përdoret nga institucioni publik përkatës, përdorimi dhe përditësimi i së cilës bëhet nga strukturat përkatëse për median dhe informimin në këtë institucion. Nuk përfshihen në këtë përkufizim llogaritë personale dhe adresat në rrjetet sociale, të cilat përmbajnë vetëm emrin dhe mbiemrin e funksionarit publik dhe nuk lidhen me funksionin publik të tij.
2. Funksionarët publikë të çdo niveli nuk mund të përdorin direkt ose indirekt llogaritë e tyre zyrtare në rrjetet sociale për qëllime partiake apo elektorale. Pasqyrimi i veprimtarive partiake dhe elektorale lejohet vetëm në llogaritë personale në këto rrjete.
3. Ndalohej pasqyrimi i veprimtarive të ndaluara në rrjetet sociale të institucionit publik, si dhe në ato zyrtare të funksionarit publik.
4. Ndalohej pasqyrimi i veprimtarive politike dhe elektorale, si dhe postimi i mesazheve elektorale në faqet zyrtare të internetit, në rrjetet sociale të institucionit publik dhe në ato zyrtare të vetë funksionarit publik.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Data: 4.3.2025 Nr: 240
Ora: 11:00



“Për rregullat e përdorimit dhe komunikimit në rrjetet sociale dhe median online nga institucionet publike dhe funksionarët publikë në zgjedhje”

1

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania